

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITEN
02 Nr./Sr. 1193/19
Nr. i rreg./Sr. Sr.
Data: / Datum 22.10.2019
VUSHTRRI - VUÇITEN




REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, si dhe duke iu referuar njoftimit datë 17.10.2019btë N.H. "Ibër Lepenc" Sh.A në Prishtinë, Kryetari i Komunës jep këtë:

URDHËRESË

1. Urdhëroj Drejtorinë për Inspektime që të ndërmerr masa të menjëhershme ligjore të rastet e ndërtimeve të objekteve të banimit, objekteve afariste dhe objekteve tjera përcjellëse mbi sistemin e gypave nëntokësor të ujitjes të N.H. "Ibër Lepenc" Sh.A. Prishtinë. Këto ndërtime përveç që mund të defunksionalizojnë sistemin e ujitjes ato paraqesin gjithashtu rrezik potencial në rast të pëlcitjes së gypave nën objektet të cilat janë ndërtuar mbi atë rrjet të ujitjes. Rasti më i theksuar i ndërtimeve të tilla është zona e fshatit Nadakoc por edhe zonat tjera në territorin e komunës.
2. Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, me rastin e shqyrtimit të kërkesave për leje ndërtimore duhet të sigurohet paraprakisht nga palët që objektet ndërtimore të mos ndërtohet mbi rrjetin e gypave nëntokësor apo në afërsi të gypave siç parashihet me legjislacionin në fuqi me të cilin është e rregulluar kjo çështje.
3. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe duhet të zbatohet menjëherë.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Inspektime
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- N.H. "Ibër Lepenc" Sh.A. Prishtinë
- Arkivit të Sekretarisë

REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITAN
02 Nr./br. 1196/19
Nr. nr./dr. si
Data: / Datum 22.10.2019
VUSHTRRI - VUČITAN




REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës jep këtë:

URDHËRESË

1. Urdhëroj rojet e pyjeve në Drejtorinë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural që të shtojnë angazhimet e tyre për kontrollim dhe mbikëqyrje të terrenit për parandalim të prerjes së pyjeve nga prerësit ilegal në territorin e Komunës. Nevoja për shtim të kontrolleve vjen si rezultat i shtimit të numrit të rasteve të dëmtimit të pyjeve nga prerësit ilegal sidomos tani kur ka filluar të ftohet koha përkatësisht ofrohet sezoni dimëror, kur kërkesat për dru për ngrohje janë në rritje.
2. Obligohet Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Udhëheqësi i Sektorit të Pyjeve që të përcjell nga afër punën e rojeve të pyjeve në terren dhe ndërmerr masa në rast të dështimeve për përmbushje të obligimeve ndaj punës.
3. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë.



Xhafër Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
- Udhëheqësit të Sektorit të Pyjeve
- Rojeve të pyjeve
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 67 “g” të Statutit të Komunës dhe nenit 17 të Rregullores (KKV) Nr.01/2018 për Përcaktimin e Kriteve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione personave juridikë – OJQ dhe ndihmë momentale personave fizikë Nr.144/18 të dt.31.05.2018, si dhe në bazë të Kërkesës 02-104/02-52992 të dt.18.09.2019, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

1. z.Shaban (Nuhi) Haliti, me nr.personal 1003056364, nga fshati Beçuk, Komuna Vushtrri, i lejohet një ndihmë financiare në shumë prej 500 € (pesëqind euro) për ndihmë financiare për ndërtim të lapidarit për vëllain e tij dëshmorë Bektesh (Nuhi) Haliti në fshatin Gllavatin.
2. Shuma e mjeteve të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi duhet të paguhet nga buxheti i komunës – fondi për transfere dhe subvencione nga Zyra e kryetarit.
3. z.Shaban (Nuhi) Haliti apo i autorizuari i tij ligjor duhet të ofroj kopjen e dokumentit të identifikimit dhe të kartelës bankare në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në Vushtrri me qëllim të implementimit të këtij vendimi.
4. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Vushtrri.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi ju dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Palës si dhe
- Arkivit të Sekretarisë

Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri